



Prishtinë, 11 nëntor 2010
Kodi i ZRRE-së: V_317_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenin 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (2004/9) të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
- Dispozitat e Nenin 8 të Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike (KEK Sh.A), dhe
- Kërkesën për Aprovimin e Standardeve të Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit, të dorëzuar me datë 21.09.2010 nga Korporata Energjetike e Kosovës (në vazhdim KEK Sh.A)-Divizioni i Furnizimit Publik,

në seancën e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN “Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike” - KEK Sh.A, (si në shtojcë të këtij vendimi), të cilat do të fillojnë të zbatohen nga data **1 janar 2011.****

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 21 shtator 2010 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes KEK Sh.A - Divizioni Furnizimit Publik, për aprovimin e dokumentit “Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike”.
- Këto standarde janë punuar duke u bazuar në Nenin 8 të Licencës së Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (KEK Sh.A), dhe identifikimi dhe përcaktimi i tyre është si rezultat i punës së grupit punues në përbërje të përfaqësuesve nga Korporata Energjetike e Kosovës (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizimi Publik me energji elektrike), Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST), Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) dhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).
- Pas nxjerrjes së draftit të fundit të këtyre Standardeve nga Grupi Punues, këto Standarde Furnizuesi Publik i ka rishikuar për pjesën që ka të bëjë me furnizuesin publik në dhe i ka dërguar për aprovim në ZRRE.
- ZRRE e konsideron të rëndësishme që të zbatohen këto standarde nga i licencuari në mbrojtje të konsumatorëve të energjisë elektrike të parapara me ligj, duke pasur parasysh se standardet janë një komponent i rëndësishëm për mbrojtjen e tyre.

- ZRRE ka analizuar dhe vlerësuar këto standarde dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuar në hyrje të këtij vendimi Bordi i ZRRE së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Këto standarde do të fillojnë të zbatohen nga i Furnizuesi Publik me Energji Elektrike, nga data 01.01.2011, ndërsa monitorimi dhe raportimi i përmbushjes së tyre do të bëhet në përputhje me procedurat e nxjerra nga ZRRE.
- III. Në rast se Furnizuesi Publik nuk vepron në përputhje me standardet e përcaktuara të kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, ZRRE do të aplikojë gjoba sipas ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullit për Masat Administrative dhe Gjobat dhe licencës së Furnizuesit Publik të lëshuar nga ZRRE. ZRRE nuk do të aplikojë gjoba për vitin e parë të monitorimit.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar